




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË VUSHTRRI/ OPŠTINSKI SUD ZA
PREKRŠAJE U VUČITRNU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN VUSHTRRI

Nr. 7794 /12

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE VUSHTRRI, gjyqtari duke vendosur ne proceduren kundervajttese kunder te pandehurit Ergyn Sunguri nga Vushtrria per kundervajtje nga neni 17,paragrafi 1 pika 1 te Ligjit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise te zyrtareve te larte publik e ne baze te nenit 73. 195 dhe 199 te LMK-es, me dt.04.10. /12 viti, bjen kete:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Ergyn Faruk Sunguri i lindur me dt.29.03.1976 ne Mitrovice kurse tani jeton ne Vushtrri rruga Mic SOkoli nr.49 i pa martuar, me shtetesi Kosovar, te kryer shkollen e mesme, gjendja ekonomike e mesme deri me tani jo i denuar per kundervajtje e as per nen hetime jo i denuar.

ESHTE FAJTOR

SEPSE: Zyrtari publik Ergyn Sunguri nga Vushtrria nuk e ka permbushe obligimin ligjor qe parasheh Ligji nr. 04/L-050 per deklarimin prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise se zyrtareve publik ne afatin ligjor prej nje maresi deri 31 mars i cili afat eshte ligjor per deklarimin e rregullt vjetor te pasuris te zyrtareve te larte publik.


Me kete ka bere kundervajtje nga neni 17 paragrafi 1 pika 1 te Ligjit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise te zyrtareve te larte publik dhe per kete:

D E N O H E T

Per kundervajtje nga neni **ME DENIM NE TE HOLLA NE SHUME PREJ 1000 euro** i pandehuri eshte i obliguar qe ne afatin prej 15 dite pas plotefuqishmeris se ketij aktvendimi e nese te njejten nuk e paguan e njejta do t'i zevendesohet me denim **BURGU** ne kohezgjatje prej 30 ditesh duke llogaritur cdo dite vuajtje te burgut 15 euro.

Obligohet i pandehuri qe ne emer te paushallit gjyqesor te paguajne shume prej 5 euro ne te njejtin afat ligjore.

Nga nje kopje te aktvendimit te dergohet



Arsy e t i m


AGJENCIA KUNDER KORUPCIONIT ne Prishtine me kerkesen e vet nr.01-2539/12 te dt.24.07 /12 viti, ka kerkuar te zhvillohet procedura kundervajtese kunder te pandehurit.

I pandehuri eshte mare ne pyetje prane kesaj gjykate dhe ne mbrojtjen e vet shton: E vertet eshte se nuk e kam bere deklarimin e rregullt vjetor te pasuris qe ka qene i obliguar sipas ligjit meqe une faktikisht kam ndegju qe duhet te dergohet nje raporte i tille por per shkaqe caktuara me ka mbet pa e dergu nje raporte i tille meqe dergimi i raportit nuk paraqet problem dhe ne te ardhmen do te kem kujdes dhe do ta beje deklarimin me kohe, keshtu qe permes imelles nuk na eshte dergu formulari ashtu qe edhe pak haresa dhe kemi mbet pa e dergu.

Gjyqtari duke i vleresuar shkresat e lendes dhe nga vet deklarata e te pandehurit konstatoi se i pandehuri eshte pergjegjes per kundervajtje qe i vihet ne bare per te njejtin e shpalli fajtor dhe e denoj si ne dispozitiv te ketij aktvendimi me bindje se edhe me kete lloje denimi do te arrihet qellimi i duhur ndaj te njejtin ne ate menyre qe ne te ardhmen mos ta perseris nje kundervajtje te tille nga se ne te kunderten do te pasoje masa shume me te ashpera ligjore ndaj te njejtin.

Nga se u cek me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE VUSHTRRI, me .dt.04.10./12 viti.


GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE VUSHTRRI
Kamer Gjykatës

KESHILLA JURIDIKE: Kunder ketij aktvendimi i pandehuri dhe fleteushtruesi mund te ushtrojne ankes ne Gjykatën e Larte per Kundervajtje ne Prishtine ne afatin prej 8 dite pas marrjes se te njejtin. Ankesa dergohet permes kesaj gjykate pa pulla.